



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 62 datë 01.08.2025

PËR

MIRATIMIN E PLANIT VEPRIMIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 01.08.2025 mbështetur në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54" detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak" i ndryshuar, Ligji 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Republikën e Shqipërisë: i ndryshuar, në mbështetje të Strategjisë për Mbrojtjen Sociale 2024-2030, *Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021-2030, Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Dokumentin e Politikave të decentralizimit të ndihmës dhe shërbimeve sociale*, Ligjin Nr.121//2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror "në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024", Vendimi i KB Nr.97 datë 18.12.2023 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2024" dhe përcaktimin e numrit të punonjësvë të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj", Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga specialistët dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

V E N D O S I:

- 1 – Të miratojë Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në bashkinë Përmet.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashki, Drejtoria e Financës, 4 (Katër) Njësitë Administrative, dhe gjithë sektorët në bashki.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE BASHKIA PËRMET

2025-2028




Tabela e Përmbajtjes

I. Hyrje: Qëllimi strategjik dhe objektivat specifike Error! Bookmark not define

1.1 Kuadri ligjor dhe institucional..... Error! Bookmark not define

II. Metodologjia

2.1- Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues

2.2 Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për në PVVBGJ 2025-2028

2.3 Konsultimet paraprake brenda bashkisë

2.4 Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2025 – 2028

2.5 Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit

2.6 Finalizimi i draft PVVBGJ 2025-2028 dhe kostimi i veprimeve të dakordësuara **Error.**

III. Një prezantim i Bashkisë Përmet.....

3.1 Popullsia dhe treguesit demografikë.....

3.2 Arsimi.....

3.3 Shëndetësia.....

3.4 Ekonomia.....

3.5 Punësimi dhe papunësia.....

IV. Vlerësimi i Kapaciteteve Institucionale, Profesionale dhe Financiare për Ofrimin e Shërbimeve të Kujdesit Social dhe Barazisë Gjinore

4.1 Struktura e Shërbimit Social dhe barazisë gjinore

4.2 Zyra për barazinë gjinore dhe dhunën në familje

4.3 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime sociale dhe barazinë gjinore

4.4 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale dhe barazisë gjinore

4.5 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesit social dhe barazinë gjinore

V. Analiza SWOT dhe përcaktimi i çështjeve kritike dhe prioriteteve

VI. VIZIONI, PRIORITETET, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE



6.1 Vizioni

6.2 Prioritetet

6.3 Fushat e nderhyrjes

6.4 Rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit:

VII. BUXHETI I PLANIFIKUAR

VIII. VËZHGIMI DHE RAPORTIMI PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMITARIV

Grupi qëndror i punës:

- | | | |
|-------------|----------|---|
| • Aulona | Meshini | N/kryetar i Bashkisë |
| • Etleva | Kreci | Drejtor financë, burime njerëzore |
| • Klaudja | Ciko | Drejtor i projekteve dhe integ. Evropian |
| • Arjana | Papapano | Drejtor i Mbësh. Sociale, arsim, kulturë, sport |
| • Kristjana | Ibrahimi | Administratore qyteti |
| • Enea | Kushe | Përgj. i zyrës juridike |
| • Suela | Rizaj | Përgj. e Qendrës Komunitare për fëmijët me aftësi ndryshe |
| • Dëfrim | Ushe | Adm shoqëror NE/PAK |
| • Entela | Ibrahimi | Antare Këshillit Bashkiak |

2- Grupet e punës për:

➤ **Vizionin dhe përparësitë.**

- | | | |
|-----------|----------|---|
| • Aulona | Meshini | N/kryetar i Bashkisë |
| • Arjana | Papapano | Drejtor i Mbësh. Sociale, arsim, kulturë, sport |
| • Klaudja | Ciko | Drejtor i Projekteve dhe Integritimit Evropian |
| • Nertila | Nebiaj | Anëtare e Këshillit Bashkiak |
| • Anxhela | Dauti | Drejtor kabineti |

➤ **Analizën e gjendjes dhe buxhetin e përafërt**

- | | | |
|-----------|---------|--|
| • Etleve | Kreci | Drejtor financë, burime njerëzore |
| • Klaudja | Ciko | Drejtor i projekteve dhe integritimit evropian |
| • Etleva | Myftari | Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit |

➤ **Vëzhgim dhe monitorim të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030:**

- | | | |
|------------|----------|---|
| • Etleva | Myftari | Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit |
| • Klaudja | Ciko | Drejtor i Projekteve dhe Integritimit Evropian |
| • Arjana | Papapano | Drejtor i Mbësh. Sociale, arsim, kulturë, sport |
| • Vangjela | Naqe | Përgj. i Buxhet, Financë |



- | | |
|---------------------|------------------|
| • Anxhela Dauti | Drejtor Kabineti |
| • Kristjana Ibrahim | Adm. qyteti |

QËLLIMET STRATEGJIKE

- Promovimi i pjesëmarrjes së gruas në vendimarrje. Rritja e përfaqësimit të grave në pozicione drejtuese në administratën publike dhe sektorët e tjerë.
- Rritja e aksesit të grave në tregun e punës.
- Krijimi i politikave dhe nismave që mbështesin punësimin dhe sipërmarrjen e grave.
- Sigurimi i aksesit të barabartë në shërbime publike dhe sociale.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve për grate dhe vajzat në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale.
- Parandalimi dhe lufta kundër dhunës me bazë gjinore.
- Zhvillimi i mekanizmave për mbështetjen e viktimave të dhunës dhe forcimi i masave parandaluese.
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi për barazinë gjinore.
- Promovimi i një kulture gjithëpërfshirëse dhe çrrënjësja e stereotipeve gjinore përmes programeve arsimore dhe fushatave sensibilizuese.

OBJEKTIVAT SPECIFIKË:

- I.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.
- I.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë.
- II.1. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.
- II.2. Investimi në prindërim pozitiv.
- III.1. Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të balancuar sipas mundësive jetën profesionale me atë personale dhe nevojën për përkujdesje për familjarët në varësi.



III.2. Nxitja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të rejave, si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive.

III.3. Nxitja e planifikimit të përgjigjshëm gjinor për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

IV.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria”.

IV.2. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

1.1 KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Nën nenin 18 të kushtetutës qartësohet shprehimisht se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”* Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentash ndërkombëtarë, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohem parashikimeve në instrumentat ndërkombëtarë të ratifikuar.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2028 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore, mbështetet në një tërësi dokumentash të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

a) *Instrumente ndërkombëtarë*

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality).¹
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA).

¹ E renditur në krye të kësaj liste për shkak të rëndësisë që ka në nivelin vendor në lidhje me vetë përgatitjen e këtij PVVBGJ. Ndonëse ky dokument nuk është i ratifikuar nga shteti shqiptar, sepse nuk ka një procedurë të tillë, pjesëmarrja në të bëhet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e vetë bashkive.



- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj.

b) Kuadri ligjor kombëtar

- Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligji Nr. 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar².
- Ligji Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji Nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

² Së bashku me Ligjin Nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, si dhe me të gjithë ndryshimet e mëparshme që ka pësuar ligji bazë Nr. 9669/2006.



1.2 METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2025-2028 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

2.1- Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk review). Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentash ekzistues apo draft dokumentash të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.

2.2- Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t'u në PVVBGJ 2025-2028. Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, identifikimi i prioritetëve bazuar në desk review të realizuar në fazën e parë, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të dhe lagjet, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë (OJF, bizneset, etj.).

2.3- Konsultimet paraprake brenda bashkisë. Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratorët e NJA-ve. Ky hap u konsiderua i domosdoshëm, së pari për të mundësuar njohjen me Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore për të gjitha/gjithë ata persona që nuk e kishin këtë informacion më herët (pra që mbajnë pozicione të caktuara në bashki por që nuk kanë qenë të pranishëm apo të angazhuar në procesin e njohjes me Kartën dhe përgatitjes së PVVBGJ 2025-2028), por edhe për të diskutuar me personat që kanë qenë pjesë e këtij procesi edhe më herët, mbi detaje që lidhen me formatin dhe përmbajtjen në tërësi të PVVBGJ, sidomos pasi u përfshinë në zbatimin e tij.

Për këtë, u ngrit Urdhri i Kryetarit me Nr.90 datë 11.03.2025 për ngritjen e Grupit të Punës me përfaqësues nga sektorë të ndryshëm të Bashkisë dhe Njësi Administrative por sidomos nga Drejtoria e Shërbimit Social pranë Bashkisë Përmet si dhe antarë të Këshillit Bashkiak.

Grupi i punës zhvilloi edhe 3 takime brenda institucionit me sektorë të ndryshëm për të diskutuar mbi prioritetet dhe objektivat e Planit për Barazinë Gjinore. Këto takime u realizuan më datat 21 Mars, 17 Prill dhe 12 Maj ku reflektoheshin sugjerimet dhe të dhënat e mbledhura si dhe bëhej analiza e situatës aktuale dhe objektivat për vitet në vazhdim.

2.4- Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2025 – 2028. Drafti i përgatitur për konsultim përmbante seksionet dhe të dhënat kryesore, vizionin, fushat e ndërhyrjes, objektivat specifike dhe masat e veprimet e parashikuara për arritjen e objektivave specifike. Në këtë draft u reflektuan edhe ndryshimet e dakordësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.

2.5- Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit. Ky proces u zhvillua mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultime u përfshinë drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, NJA-ve, OJF-të bashkëpunëtoresh, si dhe anëtare të Aleancës së Grave Këshilltare dhe të Këshillit



Bashkiak. Në konsultimin kryesor të zhvilluar më datën 23 Korrik 2025 u përfshinë rreth 45 pjesëmarrëse e pjesëmarrës.

Po kështu, në datën 3 Korrik 2025, draft PVVBGJ u postua për konsultim publik edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, i aksesueshëm në: <https://bashkiapermet.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/Draft-Plani-Vendor-i-Veprimit-per-Barazine-Gjinore-2025-2028.pdf>

Procesi i konsultimit publik qëndroi i hapur deri në datën 27 Korrik 2025.

2.6- Finalizimi i draft PVVBGJ 2025-2028 dhe kostimi i veprimeve të dakordësuara. Finalizimi i draft PVVBGJ u bë në bazë të komenteve dhe sugjerimeve të marra gjatë konsultimit të tij. Paralelisht u realizua edhe kostimi i aktiviteteve të dakordësuara.

- Miratimi i PVVBGJ 2025 – 2028 në Këshillin Bashkiak. Versioni përfundimtar i PVVBGJ i konsultuar e kostuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, PVVBGJ 2025 – 2028 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë. Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2028 i Bashkisë Përmet, u miratua me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 62 datë 01.08.2025. Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë dhe me metodologjinë e përgatitjes së PVVBGJ-ve siç sugjerohet nga KBRE³. Megjithatë, siç u përmend edhe në hyrje të këtij dokumenti, në këtë PVVBGJ 2025 – 2028 nuk janë vendosur edhe masat dhe veprimet e parashikuara në dokumenta të tjerë të bashkisë për fusha të caktuara që shkojnë në linjë me plotësimin e neneve të ndryshme të Kartës. Në vend të tyre është specifikuar dhe do insistohet të përmbushet së pari përfshirja e perspektivës gjinore në të gjithë këto plane që në momentin e përgatitjes së tyre, e së dyti do insistohet për vlerësimin e ndikimit gjinor të zbatimit të tyre, duke mundësuar kështu edhe një dokumentim e monitorim më të kujdesshëm të të gjithë veprimeve që në thelb synojnë zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi, pavarësisht nëse janë cituar apo jo ato veprime si pjesë e këtij PVVBGJ.

III. NJË PREZANTIM I BASHKISË PËRMET

Bashkia Përmet bën pjesë në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit. Ajo kufizohet në veri me Skraparin, në lindje me Bashkinë Kolonjë, në perëndim me Bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë dhe në jug me Konicën, Greqi. Qendra e Bashkisë është qyteti i Përmetit, i cili përfaqëson qendrën e zhvillimit ekonomik dhe social jo vetëm për Bashkinë e Përmetit por të gjithë komunitetit gjeografik që njihet si Lugina e Vjosës.

Bashkia e Përmetit përbëhet nga 5 (pesë) njësi administrative të cilat janë: Përmet, Çarshovë, Frashër, Petran dhe Qendër Piskovë. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra. Të gjitha njësitë e bashkisë janë njësi malore duke qenë se terreni është i pjerrët në më shumë se 45% të sipërfaqes së tij.

³ Për më shumë shiko në: <https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html>



Tabela 1 - Përbërja administrative e territoriale e bashkisë Përmet.

Bashkia	Njesitë administrative	Qytetet dhe fshatrat respektive
Përmet	Përmet	Qyteti Përmet
	Çarshovë	Fshatrat; Çarshovë, Vllaho, Psillotere, Biovizhde, Zhepë, Draçovë, Iliar, Munushtir, Strëmbec, Pëllumbar, Kanikol
	Frashër	Fshatrat; Frashër, Zavalan, Ogren, Kostrec, Gostivisht, Miçan, Verçisht, Kreshovë, Soropull
	Petran	Fshatrat; Petran, Leshnicë, Leus, Lipe, Qilarishtë, Badilonjë, Bënje, Novosele, Delvinë, Kaludh, Lupckë, Gjinakar, Ogdunan, Lipivan-Trabozishtë, Tremisht, Bodar
	Qendër Piskovë	Fshatrat; Piskove, Bual, Kosine, Rapcke, Mokricë-Zleushë, Kutal, Kosovë, Hotovë, Odriçan, Raban, Alipostivan, Borockë, Gosnisht, Pagri, Pacomit, Grabovë, Argovë

Territori i Bashkisë është i organizuar përgjatë luginës së lumit Vjosa. Njësitë e Çarshovës, Petranit, Përmetit dhe një pjesë e Qendër Piskovë shtrihen përgjatë luginës, ndërsa, njësia administrative e Frashërit përbën skajin më të largët të bashkisë dhe është terësisht një zonë malore. Jetesa përgjatë luginës përcakton edhe një standart më të mirë jetese për komunitetet lokale krahasuar me ato që jetojnë më larg luginës.

3.1 Popullsia dhe treguesit demografikë

Përmeti bën pjesë në rajonin statistikor NUTS 3– Qarku Gjirokastrë. Tabela më poshtë jep informacion në lidhje me sipërfaqen, ndarjen administrative, dhe numrin e popullsisë.

Tabela 2 - Të dhëna mbi sipërfaqen, ndarjen administrative dhe numrin e popullsisë

Sipërfaqe (km ²)	Numri i Njësive Administrative	Numri i Qyteteve	Numri i Fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Regjistrit Civil 2016	Popullsia sipas Census 2023
601.95	5	1	49	6,868	19,872	10,614

Burimi: Bashkia Përmet

Siç u përmend më lart, një pjesë e rëndësishme e territorit të bashkisë shtrihet në terren malor. Një relief i tillë kushtëzon dendësinë relativisht të ulët të popullsisë për zonat më të largëta.

Popullsia e Bashkisë sipas Regjistrit Civil 2023 raportohet 19.872 banorë. Më shumë se gjysma e popullsisë, rreth 56%, jeton në qytetin e Përmetit. Njësia administrative me numrin më të vogël të popullsisë është Frashëri. Njësitë e tjera (Çarshovë, Petran dhe Qendër Piskovë) përbëjnë 40% të



popullsisë së bashkisë. Bashkia e Përmetit ka fshatra që kanë një numër shumë të ulët banorësh, siç është fshati Frashër i cili ka 683 banorë. Kjo analizë demografike na shërben për të orjentuar disa shërbime të kujdesit social të cilat diktohen nga situata të veçanta demografike siç janë shërbimet sociale dhe shëndetsore për të moshuarit e vetmuar në zona shumë larg qytetit ose malore.

Tabela 3 - Të dhëna për numrin e popullsisë sipas njësive administrative

Njësitë administrative	Censusi 2011			Regjistri civil 2023		
	Femra	Meshkuj	Total	Femra	Meshkuj	Total
Përmet	5.028	4.832	9.860	2.984	2.961	5945
Çarshovë	1.425	1.544	2.969	463	455	918
Petran	1.550	1.540	3.090	791	831	1622
Qëndër Piskovë	1.602	1.668	3.270	845	897	1742
Frashër	314	369	683	177	210	387
Total	9.919	9.953	19.872	5.260	4.904	10.614

Burimi: Bashkia Përmet

Në tabelën e mësipërme, shihet se raporti gjinor i popullsisë në Bashkinë Përmet është i balancuar. Gratë përfaqësojnë 50% të popullsisë totale. Popullsia e grupmoshës 15-64 vjeç që përfaqëson popullsinë aktive, përbën 66% të popullsisë. Ajo që vihet re në piramidën e moshës për Bashkinë Përmet është se grupmosha 65+ vjeç, përfaqëson 18% të popullsisë, tregues ky që është më i lartë se mesatarja e vendit (11.3%). Nga ana tjetër grupmosha 0-14 vjeç përbën 16% të popullsisë së Bashkisë Përmet, tregues i ulët në krahasim me mesataren e vendit (20.7%).

Tabela 4 - Popullsia, raporti sipas grupmoshave

Popullsia sipas grupmoshave	Bashkia Përmet	Mesatarja e vendit
	%	%
0-14	16%	20.7%
15-64	66%	68%
65- e lart	18%	11.3%

Burimi: Bashkia Përmet

I gjithë territori i Bashkisë është karakterizuar nga migrimi dhe emigrimi i popullatës në dy dekadat e fundit. Të dhënat e Census 2001 dhe 2011, tregojnë se popullsia e Bashkisë Përmetit është zvogëluar me më shumë se gjysmën e popullsisë (56%). Njësia administrative Frashër në harkun kohor 2001-2011, ka patur një largim masiv të banorëve në masën 82%. Po kështu, edhe popullsia e njësive administrative Çarshovë është ulur me 71%. Përmeti (qyteti) ka përqindjen më të vogël të popullsisë së larguar (51%), krahasuar me njësitë e tjera administrative.



Të dhënat tregojnë për një rënie të konsiderueshme të popullsisë për të gjitha njësitë administrative, e cila ka si shkak kryesor migrimin e brendshëm (largimin e banorëve drejt qytetit të Përmetit dhe qyteteve të tjera) dhe emigrimin (kryesisht në Greqi). Por ulja e popullsisë është shkaktuar edhe për shkaqe të tjera. Kështu, treguesit e lindshmërisë dhe vdekshmërisë të cilët përbëjnë variablat bazë për vlerësimin e shtesës natyrore të popullsisë tregojnë se ky tregues i shprehur si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve është negativ. Tabela më poshtë paraqet numrin e lindjeve, vdekjeve, martesave, dhe divorceve në periudhat 2017-2018 dhe 2021-2024. Numri i lindjeve është shumë i ulët. Në vitin 2022 për shembull janë regjistruar vetëm 17 lindje dhe deri në gjysmën e vitit 2024, numri i lindjeve në Përmet ishte 5.

Tabela 5 - Numri i lindjeve dhe vdekjeve për dy vitet e fundit në Bashkinë Përmet

	2017	2018	2021	2022	2023	2024
Lindje	39	49	14	17	5	14
Vdekje	117	112	180	145	48	104
Martesa	15	27	42	35	21	28
Divorce	5	7	12	22	3	8

Burimi: Bashkia Përmet Zyra e Gjendjes Civile

**Shënim: Të dhënat e vitit 2023 janë të kufizuara deri në datën 30 qershor.*

Shtesa natyrore negative, migrimi dhe emigrimi kryesisht i popullatës aktive, kanë qenë faktorë të rëndësishëm të cilët kanë përcaktuar edhe tendencën e plakjes së popullsisë me ritme të shpejta. Procesi i plakjes vihet re nga rritja e lehtë e popullsisë mbi 65 vjeç, shoqëruar kjo me uljen e numrit të popullsisë në moshë të re 0-14 vjeç.

3.2 Arsimi

Zona e Përmetit është një zonë e njohur për traditat e saj arsimdashëse. Vihet re një nivel i ulët i braktisjes së shkollës 9-vjeçare, si dhe interes i lartë për vazhdimin e shkollës së mesme dhe studimeve universitare nga ana e të rinjve. Kushtet e shkollave janë relativisht të mira me një numër mesatar prej 25 nxënësish në klasë. Për shkak të migrimit dhe emigimit, numri i shkollave 9-vjeçare ka rënë me 20%. Në total, Përmeti numëron 14 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë të mesme.

Tabela 6 - Të dhëna për arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm

Shkollat nëntëvjeçare			Shkollat e mesme		
Numri i shkollave 9-vjeçare	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Numri i shkollave të mesme	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
14	538	79	1	211	20

Burimi: Bashkia Përmet



Arsimi parashkollor. Vetëm qyteti i Përmetit ka një çerdhe dhe 2 kopshte me ushqim, ka edhe 8 kopshte pa ushqim (2 në qytet dhe 6 në fshatra).

Tabela 7 - Të dhëna për arsimin parashkollor

Çerdhet			Kopshtet		
Numri i çerdheve	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve	Numri i kopshteve	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve
1	25	6	8	139	19

Burimi: Bashkia Përmet

3.3 Shëndetësia

Një rëndësi të veçantë në shërbimin shëndetësor në Bashkinë Përmet ka shërbimi parësor, ky shërbim ofrohet nëpërmjet qendrave shëndetësore, ambulancave dhe poliklinikave. Në Përmet ka një spital qendror, një ambulancë, 8 qendra shëndetësore, dhe një poliklinikë. Shërbimet spitalore trajtohen në spitalin rajonal të Gjirokastrës pasi në Përmet nuk ka mjekë të specializuar.

Problematike në spitalin Përmet mbetet mungesa e mjekëve të specializuar, gjë që sjell padyshim edhe vonesa në shërbime për moshën e tretë, por jo vetëm. Pajisja me aparatura dhe me mjekë do bënte të mundur që këto shërbime të jepeshin në kohë reale dhe nuk do përcilleshin në Gjirokastrë. Njëkohësisht lindje në Përmet nuk po realizohen prej shumë kohësh, e si rrjedhim mungon në mjet identifikimi vendlindja Përmet. Janë bërë shumë diskutime për këtë çështje, por pavarësisht dëshirës së mirë nga ana e bashkisë, kjo çështje nuk varet nga ne.

3.4 Ekonomia

Sektorët si bujqësia, blegtoaria, agroindustria, turizmi, tregtia dhe shërbimet përbëjnë drejtimit ekonomike në të cilat është e përfshirë popullsia lokale. Për shkak të natyrës mikse të ekonomisë, banorët janë të punësuar në sektorë të ndryshëm si bujqësi, industri dhe shërbime. Sektori i shërbimeve punëson numrin më të madh të forcës aktive të punës, pas këtij renditet bujqësia. Edhe pse Bashkia ka profil bujqësor, sektori i shërbimeve përfaqëson numrin më të lartë të punësimit, bujqësia përfaqëson sektorin kryesor ekonomik. Pjesa më e madhe e fermave janë të vogla dhe kryesisht familjare. Numri i ndërmarrjeve aktive në vitin 2024 është 226.

Tabela 8 - Profili ekonomik i Bashkisë Përmet

Numri i Bizneseve (Gjithsej)	Biznes i madh	Biznes i vogël	Numri i Fermave
463	70	393	-

Burimi: Bashkia Përmet

Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 81 biznese të reja ndërsa gjatë vitit 2023 operojnë rreth 226 biznese. Grupi i prodhuesve të shërbimeve vazhdon të jetë mbizotërues në ekonominë lokale të



bashkisë Përmet me rreth 95% të ndërmarrjeve aktive. Aktiviteti ekonomik “Tregtia me pakicë” përfaqëson 50% të ndërmarrjeve, ndërsa “akomodim dhe shërbimi ushqimor” i lidhur ngushtë me industrinë e turizmit përfaqëson 30%.

Tabela 9 -Numri i bizneseve të rregjistruara sipas viteve në Bashkinë Përmet

Ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik	2018	2024	2025
Totali	81	226	497
Ndërmarrje prodhuese			
• bujqësi		1	1
• industri	4	30	38
• peshkim			
Ndërmarrje shërbimesh			
• Tregëti	38	59	39
• Transport	14	26	30
• Akomodim dhe shërbim ushqimor	35	105	148
• Informacion e komunikim		5	5
• Të tjera			

Burimi: Bashkia Përmet (Sporteli i shërbimit të QKB-së në Bashki)

Ashtu siç tregohet edhe nga tabela e mësipërme, turizmi është një aktivitet ekonomik i rëndësishëm për bashkinë. Përmeti është vendi ideal për turizmin familjar dhe atë të aventurës. Megjithëse në hapat e para, zhvillimi i agroturizmit shihet si një oportunitet për punësimin e të rinjve ashtu edhe për rikthimin e familjeve që kanë emigruar nga zona.

3.5 Punësimi dhe papunësia

Statistikat e tregut të punës janë thelbësore për hartimin e Planit të Kujdesit Social. Shkalla e punësimit (raporti i të punësuarve kundrejt popullsisë në moshë pune), dhe ajo e papunësisë (raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës) janë tregues social kyç. Ky seksion i dokumentit siguron informacion mbi të dhënat e punësimit dhe papunësisë kryesisht nga Zyra e Punës Përmet.

Sipas Zyrës së Punës, numri i të papunëve në vitin 2022 ishte 956, nga të cilët 416 (44%) jetonin në zonat rurale, 428 (45%) ishin gra, 146 (15%) persona me aftësi të kufizuara, 21 (2%) egjiptianë, 13 (1%) emigrantë të kthyer, dhe 17 (2%) gra kryefamiljare.

Tabela më poshtë paraqet numrin e të papunëve sipas gjinisë dhe nivelit arsimor.



Tabela 10 - Papunësia sipas nivelit arsimor

Niveli arsimor	Femra	Meshkuj	TOTALI
Pa arsim	3	0	3
Filllore	6	5	11
9-vjeçare	232	262	494
E mesme e përgjithshme	160	190	350
E mesme profesionale	20	20	40
Arsimi universitar	23	35	58
TOTAL	444	512	956

Burimi: Bashkia Përmet

Pjesa më e madhe e të papunëve janë të lokalizuar në qendrën e bashkisë, ndjekur nga Çarçova dhe Petran. Tabela më poshtë jep informacion për numrin e të papunëve sipas njësive administrative.

Tabela 11: Të dhëna mbi papunësinë sipas njësive administrative

Njësia administrative	Femra	Meshkuj	Totali
Përmet	239	301	540
Petran	66	67	133
Çarçovë	108	101	209
Frashër	5	6	11
Piskovë	26	37	63
Totali	444	512	956

Burimi: Bashkia Përmet

.IV Vlerësimi i Kapaciteteve Institucionale, Profesionale dhe Financiare për Ofrimin e Shërbimeve të Kujdesit Social dhe Barazisë Gjinore

4.1 Struktura e Shërbimit Social dhe barazisë gjinore

Në Bashkinë Përmet funksionon Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit dhe Kulturës. Në katër njësitë administrative të Bashkisë ka nga një administrator shoqëror, ndërsa në qytetin e Përmetit janë dy punonjës, nga të cilët një administrator shoqëror për ndihmën ekonomike dhe një për skemën e pagesës së paaftësisë. Njëkohësisht, pranë kësaj drejtorie operon dhe Koordinatori Vendor i Barazisë Gjinore dhe Adresimit të Dhunës në Familje si dhe Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve. Në katër njësitë administrative ky funksion mbulohet nga administratorët shoqërorë. Në tabelën e mëposhtme nuk janë përfshirë punonjësit e arsimit dhe kulturës.



Tabela 12 - Numri i punonjësve të shërbimit social dhe barazisë gjinore sipas njësive administrative dhe funksionit

Njësia Administrative	Numri i punonjësve
Përmet	1 Drejtor i Shërbimit Social, Arsim, Kulturës 1 Përgjegjëse Sektori e Shërbimit Social 1 Specialist, NE 1 Specialist, PAK 1 Specialist, Dhuna ne familje dhe NJMF
Piskovë	1 për NE dhe PAK & dhuna ne familje
Frashër	1 për NE dhe PAK & dhuna ne familje
Petran	1 për NE dhe PAK & dhuna ne familje
Çarshovë	1 për NE dhe PAK & dhuna ne familje
Totali	9 Punonjës

Burimi: Bashkia Përmet

Misioni i Drejtorise se Shërbimit Social dhe barazisë gjinore është evidentimi i grupeve në nevojë brenda territorit të Bashkisë Përmet dhe ofrimi i ndihmës se nevojshme ekonomike dhe shërbimin e duhur të kujdesit social. Detyrat specifike te Shërbimit Social dhe barazisë gjinore janë përcaktuar nga Ligji 44/2016, Neni 30 “detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës perkatëse” dhe neni 31 “detyrat e administratorit shoqëror”.

Të qëniti drejtori ka krijuar lehtësira te mëdha në administrimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme sociale. Ofrimi i shërbimeve vështirësohet nga mungesa e stafit të specializuar. Veçanërisht nevojat për shërbime sociale për viktimat e dhunës në familje, të moshuarit e vetmuar, PAK apo komunitetet, janë edhe nevojat më frekvente për të cilat shërbimet dhe personeli që i ofron gjithmone do mbeten të pamjaftueshem. Koordinatori për barazinë gjinore dhe dhunën në familje mbulon njëkohësisht edhe NjMF. Ndërkohë që administratori shoqëror në NjA mbulon të dyja skemat e mbrojtjes sociale (në parë), atë të NE dhe PAK.

4.2 Zyra për barazinë gjinore dhe dhunën në familje

Zyra për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje (ZBGj) është ngritur në muajin Dhjetor 2012 me mbështetjen e UNDP. ZBGj punon për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi problemet gjinore me të cilat përballen komuniteti i bashkisë Përmet si dhe me menaxhimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Kjo zyrë kryen aktivitete të ndryshme ndërgjegjësimi në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile. Në kuadrin e funksioneve të saj Koordinatori organizon një herë në muaj mbledhjen e ekipit teknik multidisiplinar ku diskutohen rastet e raportuara të dhunës në familje dhe një herë në katër muaj mbledh Mekanizmin e Referimit për referimin e rasteve te identifikuar. Në funksion të zgjidhjes së rasteve emergjente të dhunës në familje ekziston një



strehëz e “përshtatur” pranë konvikteve, ku viktimat qëndrojnë deri në 72 orë, aq sa u nevojitet për marrjen e urdhërit të mbrojtjes nga gjykata.

Gjatë periudhës 2012-2013 PNUD-i u ka ofruar asistencë teknike tetë bashkive në bazë të Letër-Marrëveshjeve (i) për krijimin e RKK (Reagim i Koordinuar i Komunitetit) dhe ndërtimin e kapaciteteve për përfshirjen e perspektivës gjinore në planet e zhvillimit vendor. Veçanërisht në bashkinë Përmet, ku nuk ka OJF të specializuara që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje, roli i specialisteve për çështjet BGj dhe DhF ka një rëndësi shumë të madhe. Shërbimet ndër-disiplinore, në veçanti ato të konsulencës ligjore dhe mbështetjes psiko-emocionale ofrohen brenda institucionit të bashkisë.

Në vitin 2019, me mbështetjen teknike të Programit të Kombeve të Bashkuara “Askush te Mos Mbetet Pas,” që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, e cila zbatohet nga UNDP, u ngrit Qendra Komunitare Për Fëmijët me Aftësi Ndryshe. Në këtë qendër marrin shërbim rreth 13 fëmijë, ku aplikohet terapi zhvillimi dhe ka logoped, psikolog, dhe katër punonjëse të trajnuara nga UNDP.

4.3 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime sociale dhe barazisë gjinore

Drejtoria e Shërbimve Sociale në Bashkinë e Përmetit në bashkëpunim me institucionet publike lokale dhe qëndrore si dhe me organizata të shoqërisë civile ofron disa shërbime sociale për individët, familjet dhe grupet në nevojë. Megjithatë hendeuku ndërmjet nevojave dhe mundësive për të ofruar shërbime është i madh si nga pikëpamja sasiore (mjaftueshmërisë) ashtu edhe nga pikëpamja cilësore (përshtatshmërisë).

Në njësitë administrative nuk funksionojnë “grupet multidisiplinare për vlerësimin dhe referimin e rasteve”. Administratorët shoqëror të NjA-ve janë të fokusuar tek verifikimi i ligjshmërisë së përfituesve të pagesave në para (ndihmë ekonomike dhe pagesë së aftësisë së kufizuar etj), por nuk lënë jashtë vëmendjes edhe verifikimin e nevojave për shërbime që lidhen me rastet e dhunës në familje abuzimit dhe problematikave të fëmijëve. Falë bashkëpunimit që kanë me koordinatoren vendor të bashkisë, me marrjen e rastit bëhet e mundur mbledhja e grupit teknik multidisiplinar dhe merren masa të menjëhershme për zgjidhjen e problemit.

Punonjësit e Bashkisë janë të mirë arsimuar dhe të motivuar për të ofruar shërbime cilësore në përputhje me nevojat e komunitetit. Megjithatë domosdoshmëria për të përmirësuar kapacitetet e burimeve njerëzore dhe aftësitë e tyre profesionale është imediate. Kjo për shkak të ndryshimeve sociale që kanë ndodhur në komunitet si dhe në përgjigje të dy reformave, asaj administrative e territoriale dhe reformës së shërbimeve sociale. Vështirësitë kryesore kanë të bëjnë me gjetjen dhe mbajtjen e stafit të kualifikuar dhe sigurimin e trajnimeve në vazhdimësi të stafit ekzistues. Përmirësimi i strukturave nga njëra anë dhe ai i kapaciteteve profesionale të stafit nga ana tjetër është një kërkesë imediate për Bashkinë Përmet.



4.4 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale dhe barazisë gjinore

Shpesh herë ndodh që shërbimet sociale, të mos jenë prioritet i politikave vendore dhe kjo shprehet edhe në planifikimin dhe përdorimin e burimeve financiare vendore për këto shërbime. Buxhetet e kufizuara që u vihen në dispozicion shërbimeve sociale përkthehen në numrin e kufizuar të këtyre shërbimeve të ofruar nga Bashkia. Tabela 13 dhe Tabela 14 paraqesin buxhetin e bashkisë sipas burimit të financimit dhe shpenzimet për programet e mbrojtjes sociale dhe kujdesit social. Shpenzimet e bashkisë përqëndrohen tek strehimi.

Tabela 13 - Buxheti i bashkisë sipas burimit të financimit 000/lekë

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	40078	38741	63465	97128	124928	105384
<i>Të ardhura nga taksat lokale</i>	13962	9794	19057	23782	23845	23912
<i>Të ardhura nga taksat e ndara (grante)</i>	5437	8852	7618	7826	7850	7880
<i>Të ardhura nga tarifat vendore</i>	18018	16866	32090	35097	35272	35510
<i>Të ardhurat e tjera</i>	3561	3229	4700	30403	57961	38082
TË ARDHURAT NGA BUXHETI QENDROR	187148	203845	241993	259641	824742	1548169
<i>Transferta e pakushtëzuar</i>	187148	203845	122060	140283	160409	170672
<i>Transferta e kushtëzuar për funksione të deleguara</i>					565037	1278845
<i>Për projekte të veçanta</i>			39414	261111	874	
<i>Transferta specifike</i>			80519	93247	98422	98652
HUAMARRJA						
<i>Huamarrja afatshkurtër</i>						
<i>Huamarrja afatgjatë</i>						
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR			53275	139021		
<i>Trashëgimi pa destinacion</i>			27097	38317		
<i>Trashëgimi me destinacion</i>			26178	100704		
TOTALI I BURIMEVE BUXHETORE	228126	242386	356733	495730	949670	1653553

Burimi: Bashkia Përmet

Tabela 14 - Shpenzimet për programet e mbrojtjes, kujdesit social dhe barazisë gjinore të Bashkisë

PROGRAMET	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022	VITI 2023	VITI 2024
<i>Sëmundjet e aftësisë së kufizuar për të gjitha kategoritë</i>	86396	82159	80345	51718	
<i>Ndihma ekonomike</i>	7308	6946	7439	4202	
<i>Familja dhe Fëmije, Individë</i>					
<i>Papunësi</i>					
<i>Strehim</i>		681	1164	1545	
Totali					

Burimi: Bashkia Përmet



4.5 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesit social dhe barazinë gjinore

Ajo çfarë vërehet në Bashkinë e Përmetit është se ka një mungesë të theksuar të organizatave jo-fitimprurëse. Aktualisht, ka 11 organizata aktive (shih më poshtë) por asnjë prej tyre nuk është me karakter social.

- CESVI Cooperazione e Sviluppo - ONLUS
- CIOFF - Seksioni Ndërkombëtar Shqiptar
- Mjedis, Ujëra, Pyje
- Qendra Rajonale e Zhvillimit të Integruar (QRZHI)
- Royal Albania Foundation
- PRO Përmet
- Convivium Slow Food Përmet
- Shoqata e Alpinizimit dhe Turizmit Malor Përmet
- Solidarity Now
- FLOEM
- VJOSA EXPLORER

V. Analiza SWOT dhe përcaktimi i çështjeve kritike dhe prioritetve

Përmeti është një nga zonat me potencial zhvillimi ekonomik dhe social nga më të favorshmet në Shqipëri, për arsye të avantazheve ekonomike të qytetit dhe zonës së bashkisë në tërësi. Shfrytëzimi i këtij potenciali ekonomik në bazë të politikave vendore është i rëndësishëm për zhvillimin social, për të mundur që të jetë gjithëpërfshirës. Analiza e të dhënave administrative si dhe perceptimet mbi vulnerabilitetin të artikuluara nga grupet e interesit gjatë hartimit të Planit, tregojnë se ka vend për politika sociale vendore të kujdesshme për të arritur pikërisht ato grupe që janë më në nevojë.

Në kushtet e burimeve të kufizuara financiare dhe njerzore të Bashkisë, analiza SWOT e realizuar me grupet e interesit na siguroi që të ndërtojmë një plan veprimi me konsensusin e të gjithë aktoreve. SWOT na mundësoi gjithashtu të marrim një pozicion të qartë rreth aftësive dhe mundësive që bashkia ka aktualisht si edhe rreth mundësive për të përmirësuar kapacitetet institucionale, materiale dhe njerëzore.

Tabela 15. Analiza SWOT

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA
• Një Bashki me potenciale ekonomike dhe kulturore të mëdha. • Popullsi relativisht të vogël që krijon mundësi për njohje shumë të mira mbi nevojat e territorit dhe grupeve në nevojë.	• Niveli i lartë i papunësisë tek të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi ndryshe. • Shkalla e lartë e emigracionit jashtë vendit. • Mungesa e infrastrukturës arsimore për zhvillimi e aftësive profesionale.



• Popullsia homogjene me karakteristika shumë të mira të kohezionit social. • Potenciale ekonomike dhe burime natyrore avantazhuese krahasuar me qytete të tjera. • Një bashkëpunim shumë i mirë institucional midis nivelit qendror dhe lokal. • Staf i përkushtuar dhe dedikuar në ofrimin e shërbimeve. • Një numër i konsiderueshëm specialistësh të trajnuar për ofrimin e shërbimeve sociale duke adresuar grupe të veçanta.	• Mbulese e ulët me shërbime shëndetësore në të gjithë territorin e bashkisë. • Politikat sociale lokale deri diku të munguara të Bashkisë së Përmetit për përfshirjen e personave me aftësi ndryshe (gra,vajza). • Mungesa e shërbimeve të integruara. • Burime të kufizuara financiare. • Terren i thyer malor në zonat rurale • Grupet e interesit nuk janë të mirë-organizuar dhe kompakte në prezantimin e problemeve të tyre.
MUNDËSITË • Angazhim i pushtetit vendor në Bashkinë e Përmetit për respektimin e traditës dhe të drejtave të njeriut. • Bashkia Permet dhe stafi është i angazhuar për të bashkëpunuar me partneret ndërkombëtare. • Ekzistenca e organizatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe mekanizmave që i vlejné procesit të përfshirjes sociale, barazisë gjinore dhe angazhimin e grupeve të interesit në këtë proces. • Disa prej reformave të ndërmarra në vend adresojné grupet e përjashtuara, (reforma kundër informalitetit, reforma e ndihmës ekonomike, reforma e pensioneve, reforma arsimore, etj.). • Reforma territoriale dhe Ligji i ri 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” zgjeron hapësirën e pushtetit vendor për përfshirjen sociale të grupeve të përjashtuara.	RREZIQET • Reforma territoriale dhe zgjerimi i hapësirës territoriale të funksionimit të pushtetit vendor të Bashkisë së Përmetit, ka bërë që shumë nga problemet e barazisë gjinore dhe ekonomike të popullatës që kanë qenë jashtë territorit të Bashkisë, të mos njihen dhe për rrjedhojë të neglizhohen. • Një tërheqje e madhe e të rinjve drejt Tiranës. • Levizjet migratore brenda dhe jashtë vendit gjatë 20 viteveve fundit. • Legjislacioni në ndryshim të vazhdueshëm. • Ndryshimi i burimeve njerëzore (pothuajse çdo katër vjet).



VI. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

6.1 Vizioni:

“Gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Përmetit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantes/emigrantit e azilkërkuases/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

6.2 Prioritetet

- 1-Fuqizimi ekonomik i gruas .
- 2-Përfaqësimi në vendimmarrje.
- 3 -Parandalimi i dhunës gjinore.
- 4-Barazi në arsim dhe kulturë.
- 5 -Shërbime sociale të ndjeshme gjinore
- 6.-Mbështetje për gratë në zonat rurale.

Parimet që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, siç paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjithë grupet, përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.



6.3 Fushat kryesore të ndërhyrjes.

PVVBJ 2025 – 2028 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Avancimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.
- II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.
- III. Avancimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm.
- IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe efikasitetit të qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumentave të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

6.4 Rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit:

Fusha e ndërhyrjes:	
I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.	
Rezultatet e pritshme:	
I.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.	
I.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë.	
Objektivat specifike:	
I.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.	



I.b. Buxheti i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë.

Treguesit në nivel objektiv:

I.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të publikuara në faqen e internetit të bashkisë.

I.2.a. Numri i raporteve të monitorimit të shpenzimeve vjetore për programe buxhetore të caktuara, të analizuara nga këndvështrimi gjinor, të publikuara në faqen e internetit të bashkisë.

I.2.b. Numri i dokumentave të rëndësishëm vendorë të hartuar me ndjeshmëri gjinore /monitoruar nga këndvështrimi gjinor.

Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë fushë ndërhyrjeje synojnë të përmirësojnë më tej transparencën dhe llogaridhënien e Bashkisë jo vetëm kundrejt qytetareve dhe qytetarëve të saj. Kjo ndikon njëkohësisht edhe tek rritja e besimit të komunitetit tek ky institucion. Përshtetëzimi i veprimeve duke kaluar në fuqizimin e strukturave të brendshme të bashkisë për të bërë analizën gjinore të buxheteve dhe vlerësimin e ndikimit gjinor të veprimeve të zbatuara, do të jenë ndihmuese edhe për një zbatim sa më të mirë të legjislacionit në fuqi lidhur me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

Fusha e ndërhyrjes:

II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.

Rezultatet e pritshme:

II.a. Një brez i ri i barazisë, i krijuar, që lufton stereotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë.

II.b. Informimi dhe mundësi për grate, vajzat dhe grupet e marginalizuara të shumëfishtë

Objektivat specifikë:

II.1. Promovimi i edukimit gjithëpërfshirës dhe sensibilizues mbi barazinë gjinore në sistemin arsimor.

II.2. Rritja e aksesit të barabartë në shërbime dhe mundësi për grate, vajzat dhe grupet e marginalizuara që përballen me disavantazhim të shumëfishtë.

Treguesit në nivel objektiv:

II.1.a. Përqindja e shkollave që kanë integruar modulet mbi barazinë gjinore.

II.2.a. Përqindja e të rinjve që tregojnë ndryshim pozitiv në qëndrime ndaj roleve gjinore pas përfshirjes në programe edukative

II.2.b. Përqindja e vajzave dhe grave që marrin pjesë në programe për zhvillim ekonomik dhe punësim.

II.2.b. Numri i shërbimeve sociale me qasje gjithëpërfshirëse për grat dhe grupet e marginalizuara.

II.2.b. Numri i rasteve të raportuara dhe trajtuara për diskriminim gjinor dhe disavantazh të shumëfishtë.



Masat e parashikuara nën këtë objektiv specifikë synojnë të fokusohen në evidentimin e modeleve pozitive nxitëse për thyerjen e stereotipeve gjinore. Do të synohet nga njëra anë informimi dhe edukimi mbi çështjet e barazisë gjinore dhe mos diskriminimit në tërësi dhe nga ana tjetër promovimi i modeleve dhe nxitja e të rejave dhe të rinjve që të krijojnë brezin e barazisë, ku të gjithë individët në shoqëri shpalosin potencialet e tyre duke lënë mënjane diskriminimin, disavantazhimin dhe të gjitha praktikatat e dëmshme që e mbajnë familjen dhe shoqërinë larg barazisë dhe drejtësisë gjinore. Riorganizimi i punëve dhe detyrimeve brenda familjes, ku secila/secili të kujdeset për veten dhe të tjerët, duke mos ia lënë më këtë barrë vetëm gruas si “pjesë e detyrave të saj”, do të jetë gjithashtu në fokus të veprimeve të parashikuara nën këtë objektiv specifik, ku do të synohet edhe shpjegimi i aspekteve pozitive të balancimit të jetës personale me atë profesionale. Sa më sipër do të shoqërohet padyshim edhe me hapa konkretë për investimin në prindërimin pozitiv dhe komunikimin e duhur prind-fëmijë.

Fusha e ndërhyrjes:

III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tranzicioni i gjelbër (mjedisor) dhe transformimi digjital.

Rezultatet e pritshme:

- III.a. Veprimet e bashkisë për të krijuar një mjedis punësimi ku harmonizohet jeta personale me atë profesionale, të rritura ndjeshëm.
- III.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, me fokus ekonominë mjedisore, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.
- III.c. Veprimet vendore për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, të parashikuara si veprime të përgjigjshme gjinore.

Objektivat specifikë:

- III.1. Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të balancuar sipas mundësive jetën profesionale me atë personale dhe nevojën për përkujdesje për familjarët në varësi.
- III.2. Nxitja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave dhe të rejave, si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive.
- III.3. Nxitja e planifikimit të përgjigjshëm gjinor për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Treguesit në nivel objektiv:

- III.1.a. Numri i personave të pajisur me informacion për luftimin e stereotipeve gjinore në punësim dhe balancimin e jetës profesionale dhe personale.
- III.2.a. Numri i grave dhe të rejave sipërmarrëse të mbështetura për përparimin drejt zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.
- III.3.a. Numri i grave, të rejave e vajzave të pajisura me informacion për njohjen e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.
- III.3.b. Numri i planeve/dokumentave vendorë, të përgjigjshëm gjinorë, të hartuar për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.



Ndër masat kryesore të parashikuara këtu evidentojmë ato që lidhen me një njohje më të mirë të legjislacionit dhe shërbimeve për nxitjen e punësimit, të cilat domosdoshmërisht çojnë në aplikimin e duhur të tyre. Informimi i të rejave dhe të rinjve mbi programet ekzistuese të nxitjes së punësimit apo mbi iniciativat mbështetëse për fillimin e aktiviteteve ekonomike, do të sjellë një rritje të interesit të tyre për të aplikuar. Po kështu, do të synohet edhe mbështetja e iniciativave që lidhen me digjitalizimin, ekonominë mjedisore, por edhe ruajtjen dhe përcjelljen e trashëgimisë kulturore. Në fokus do të jenë edhe veprimet për njohjen dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, si dhe hedhja e hapave për të përgatitur plane të dedikuara vendore për këtë qëllim, të cilat duhet të jenë plane të përgjigjshme gjinore.

Fusha e ndërhyrjes:

IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Rezultatet e pritshme:

IV.a. Informimi dhe elementët e sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike e private, të rritura ndjeshëm.

IV.b. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe eficient.

Objektivat specifikë:

IV.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria”.

IV.2. Fuqizimi dhe rritja e eficensës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Treguesit në nivel objektiv:

IV.1.a. Numri i misionëve të auditimit të sigurisë të zhvilluara nga stafi i bashkisë në bashkëpunim me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike.

IV.2.a. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë fushë të ndërhyrjes synojnë përmirësimin e nivelit të sigurisë në hapësirat publike përmes koordinimit të veprimeve ndërmjet të gjithë aktorëve dhe mekanizmave përgjegjës të ngritur tashmë për këtë qëllim, si dhe rritjen e efektivitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore. Informimi dhe edukimi për të njohur më mirë të drejtat dhe mbrojtjen që ofrohet, do të shoqërohet dhe me shërbime të specializuara të cilat ofrohen sipas standardeve por edhe që mbështeten më shumë financiarisht nga bashkia. Po kështu gjetja e zgjidhjeve për të mundësuar ri-integrimin e plotë të viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje e të dhunës me bazë gjinore, do të jetë një tjetër drejtim në të cilin do të punohet gjatë këtyre viteve



Fusha e ndërhyrjes

I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.

✓ Objektiva specifike

a-Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.

b-I.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë

Aktiviteti	Afati	Burimet	Monitorimi
Hartimi dhe publikimi i raportit vjetor për barazinë gjinore në bashki	Çdo vit	Njësia për barazinë gjinore, drejtoria e statistikave, buxheti vendor	Raporti i publikuar në faqen e bashkisë dhe diskutim në këshillin bashkiak
Dëgjesa publike me qytetarë dhe grupet e interesit mbi barazinë gjinore	Çdo gjashtë muaj	Stafi i bashkisë. OSHC lokale	Procesverbalet e dëgjësive, nr. i pjesëmarrësve, rekomandime të mbledhura
Trajnime për stafin vendor mbi komunikimin public dhe raportimin gjinor	2 herë në vit	Ekspertë nga Agjencia e barazisë gjinore, OSHC, donatorë	Vlerësime, certifikata pjesëmarrjeje
Përfshirja e analizës gjinore në procesin e hartimit të buxhetit Afatmesëm dhe Strategjisë	Çdo vit	Drejtoria e Shërbimit Social, Finacës, njësia gjinore, këshilltar të jashtëm	Dokumentet buxhetore dhe strategjike dhe shtojca të analizës gjinore
Hartimi i matricave buxhetore me tregues gjinorë për çdo program bashkiak	2025 dhe çdo vit	Zyrtarë të buxhetit, statistika, konsulentë të barazisë gjinore	Krahasimi në vite, progress në përfshirjen gjinore në alokime
Auditim i brendshëm për të verifikuar respektimin e buxhetit gjinor	2026-2028	Njësia e auditimit, bashkia	Raporti i auditimit



Fusha e ndërhyrjes

II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.

✓ Objektiva specifike

a-Promovimi i edukimit gjithëpërfshirës dhe sensibilizues mbi barazinë gjinore në sistemin arsimor.

b)Rritja e aksesit të barabartë në shërbime dhe mundësi për grate,vajzat dhe grupet e marginalizuara që përballen me disavantazhim të shumëfishtë

Aktiviteti	Afati	Burimet	Monitorimi
Hartimi dhe integrimi i moduleve për barazinë gjinore në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme.	2025-2026	Ekspert të barazisë gjinore,MAS, donatorë	Raport vjetor mbi kurrikulat,inspektime në shkollë
Organizimi i trajnimeve për mësuesit mbi edukimin gjinor	2026	Drejtoria arsimore,organizata të shoqërisë civile,trajner të certifikuar	Vlerësimi i pjesëmarrësve para dhe pas trajnimit
Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve educative (postera,broshura,video educative)	2025-2026	Institucione educative,fonde publike	Numër materialesh të shpërndara dhe vlerësimi nga përfituesit
Ofrimi i kurseve profesionale për gratë dhe vajzat në zonat rurale	2026-2027	Bashkia,Agjensia Kombëtare e Punësimit, donatorë	Regjistrat e pjesëmarrësve,ndjekja e rezultateve pas kurseve
Trajnime me punonjës të shërbimeve publike për parandalimin e diskriminimit gjinor	2026	Administrata publike,trajner,OSHC	Raport pas trajnimit,raste të identifikuara të diskriminimit
Zhvillimi i një platforme online për raportimin e diskriminimit të dhunës me bazë gjinore	2027-2028	IT ekspertë,organizata të specializuara,fonde shtetërore,donator	Numri i raportimeve,analiza e përgjigjeve institucionale



Fusha e ndërhyrjes

III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tranzicioni i gjelbër (mjedisor) dhe transformimi digjital

✓ Objektivat specifike

- a) Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të balancuar sipas mundësive jetën profesionale me atë personale dhe nevojën për përkujdesje për familjarët në varësi.
- b) Nxitja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të rejave, si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive.
- c) Nxitja e planifikimit të përgjigjshëm gjinor për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Aktiviteti	Afati	Burimet	Monitorimi
Hartimi i një udhëzuesi local për punëdhënësit mbi praktikat për punësim pa stereotipe dhe mbështetëse për kujdesin familjar	2025-2026	Njësi për barazinë gjinore, burimet njerëzore	Publikimi dhe shpërndarja e udhëzuesit, feedback nga punëdhënësit
Krijimi i një skeme pilot për fleksibilitet orari dhe punë nga shtëpia për prindërit kujdestarë në institucionet publike vendore	2026	Drejtoria e burimeve njerëzore, IT, bashkia	Raport testimi nga punonjësit pjesëmarrës dhe vlerësim efektiviteti
Mbështetje për krijimin e qendrave ditore të fëmijëve	2025-2026	Bashkia, partnerë social, donatorë	Numri i qendrave, përdorimi dhe kënaqësia e qytetarëve
Trajnimin për gra dhe vajza mbi sipërmarrjen, menazhimin dhe aksesin në financë	2025 dhe çdo vit	Drejtoria e finances, dhoma e tregëtisë, banka	Numri i pjesëmarrësve, ndjekja e suksesit të sipërmarrjeve
Krijimi i një skeme subvencionimi apo granti për grate sipërmarrëse të kthyer nga emigracioni në fazën fillestare	2025-2026-2027-2028	Buxheti vendor, donator, programe PARD ose BE	Numri i aplikimeve, rezultatet ekonomike të përfituesve
Partneritet me bankat/mikrofinancat për ofrimin e produkteve të përshtatura për gratë	2026 -2028	Sektori privat, OSHC, bashkia	Numri i marrëveshjeve dhe produkteve të ofruara me kushtet lehtësuese
Përfshirja e analizës gjinore në	Çdo vit	Drejtoria e	Kontroll cilësor i



planet e menaxhimit të rreziqeve dhe emergjencave civile		emergjencave,njësia gjinore	dokumenteve dhe miratim nga këshilli bashkiak
Trajnimi me stafin e emergjencave mbi nevojat gjinore në kohë krize(ushqim,stehim,siguri)	2025-2026	Drejtoria e emergjencave,mbrojtja civile	Raporte trajnimi,skenarë të përmirësuar operacional
Krijimi i një database me grupe vulnerabël (gra të vetëmuara,të moshuar,PAK) për reagime të shpejtë	2026	Zyra të shërbimeve sociale,IT,struktura komunitare	Rishikimi dhe përditësimi i të dhënave çdo 6 muaj

Fusha e ndërhyrjes

IV -Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

✓ Objektivat specifike

a) Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria”.

b) Fuqizimi dhe rritja e eficensës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Aktiviteti	Afati	Burimet	Monitorimi
Hartimi i një vlerësimi të riskut gjinor në hapësirat publike (ndriçim,kamera sigurie),akses për gra e vajza	2026-2027	Drejtoria e urbanistikës,njësia gjinore	Raport vlerësimi me rekomandime dhe plan veprimi
Fushatë informimi për publikun mbi Rezolutën 1325 dhe rëndësinë e përfshirjes së grave në siguri dhe vendimmarrje	Çdo vit	OSHC,shkolla, mbështetje nga agjenci ndërkombëtare	Numër pjesëmarrësish në fushatë,sondazhe
Trajnime për punonjësit e bashkisë, policinë locale mbi Rezolutën 1325 dhe sigurinë gjinore	1 herë në vit	Ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë,Ministria e Mbrojtjes	Vlerësim trajnimi,aplikimi i njohurive në praktikë
Takime të rregullta mujore të Mekanizmit Vendor të Referimit për shqyrtimin e rasteve dhe ndjekjen e	Çdo muaj	Koordinatori i MR,institucione pjesëmarrëse	Procesverbal të takimeve,numë rastesh të trajtuara



protokolleve			
Krijimi një sistemi digjital për ndarjen kofidenciale të informacionit për rastet e dhunë	2026	IT,Njësia e dhunës në familje,mbështetje teknike nga partnerë	Funksionimi i sistemit,siguria e të dhënave, reagime të aktorëve

VII. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2025 - 2028

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në PVVBGJ 2025 – 2028 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Bashkia, kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Bashkia e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra specialisteve / specialistëve, të cilat / cilët aktualisht marrin një page fikse, sallave / ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin), etj., në këtë Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore 2025 - 2028 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Në seksionin VIII “Matrica e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2028”, për çdo masë/aktivitet të parashikuar, në kolonën e kostos jepet informacion për:

- Vlerën totale të kostos të zbatimit të masës/aktivitetit.** Kjo kosto është përllogaritur si kosto bazë (pra me zërat që përmban zbatimi i aktivitetit), e shumëzuar me numrin e aktiviteteve të parashikuara për zbatim për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të PVVBGJ (pra për tre vite).
- Vlerën e kostos që mbulohet nga Bashkia.** Këtu duhet pasur parasysh se kjo vlerë jo domosdoshmërisht është shtesë në buxhetin e bashkisë, ajo mund të jetë edhe në formën e angazhimit të pjesshëm të specialisteve/specialistëve të drejtorive përkatëse (pra disa ditë pune ia kushtojnë zbatimit të masës/aktivitetit, brenda pagës mujore që kanë), ose në formën e kontributit “në natyrë” përmes vënies në dispozicion të sallave e ambienteve, etj. Po kështu, në ato raste kur masa apo veprimi është i parashikuar si detyrim parësor në një tjetër plan veprimi, në lidhje me kostot, është cituar referenca në planin përkatës, për të shmangur kështu mbivendosjet në përllogaritjet financiare.
- Vlerën e kostos që mbulohet nga donatorët.** Kjo nënkupton që për zhvillimin e masës/aktivitetit ka një dakordësi paraprake me donatorët mbi kontributin e tyre.
- Hendeku financiar.** Kjo ka të bëjë me vlerën e kostos të pa mbuluar nga asnjë burim në momentin e miratimit të këtij plani. Kjo vlerë mund të mbulohet përmes negociimit me



donatorët, bizneset, OJF të specializuara, median, universitetin, etj., ose mund edhe të parashikohet brenda Planeve Buxhetore Afatmesme (PBA) e buxheteve vjetore, duke filluar nga PBA 2026-2028.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2028, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PVVBGJ nuk merr jetë, Bashkia duhet të përfshijë në parashikimet buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në të. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë gratë këshilltare për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve / masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Bashkisë, është domosdoshmëri.

Fushat e ndërhyrjes	Objektivat specifike	Gjithsej kosto për tre vjet	Bashkia	Donatorë të konfirmuar
I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.	I.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.	2,030,400 lekë	50,000 lekë	1,980,400 lekë
	I.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.	100,000 lekë	100,000 lekë	0 lekë
Gjithsej Fusha e ndërhyrjes I:		2,130,400 lekë	150,000 lekë	2,030,400 lekë
Fushat e ndërhyrjes	Objektivat specifike	Gjithsej kosto për tre vjet	Bashkia	Donatorë të konfirmuar
II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe	II.1. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore	250,000 lekë	250,000 lekë	0 lekë
	II.2. Investimi në prindërimin pozitiv	2,684,268 lekë	2,684,268 lekë	0 lekë



disavantazhim të shumëfishtë.				
Gjithsej Fusha e ndërhyrjes II:		2,934,268 lekë	2,934,268 lekë	0 lekë
Fushat e ndërhyrjes	Objektivat specifike	Gjithsej kosto për tre vjet	Bashkia	Donatorë të konfirmuar
III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tranzicioni i gjelbër (mjedisor) dhe transformimi digjital.	III.1. Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të balancuar sipas mundësive, jetën profesionale me atë personale dhe nevojën për përkujdesje për familjarët në varësi.	2,676,000 lekë	2,676,000 lekë	0 lekë
	III.2. Nxitja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të rejave, si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive.	1,200,000 lekë	0 lekë	1,200,000 lekë
	III.3. Nxitja e planifikimit të përgjigjshëm gjinor për përbalimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.	100,000 lekë	100,000 lekë	0 lekë
Gjithsej Fusha e ndërhyrjes III:		3,976,000lekë	3,976,000	0 lekë



Fushat e ndërhyrjes	Objektivat specifike	Gjithsej kosto për tre vjet	Bashkia	Donatorë të konfirmuar
IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.	IV.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 "Gruaja, Paqja, Siguria".	500,000 lekë	500,000 lekë	0 lekë
	IV. 2. Fuqizimi dhe rritja e eficensës së qasjeve shumë-sektoriale të koordinuara kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.	150,000 lekë	150,000 lekë	0 lekë
Gjithsej Fusha e ndërhyrjes IV:		650,000 lekë	650,000 lekë	0 lekë

Për më shumë detaje, lutemi referohuni tek Matrica e Planit Vendor të Veprimit në vijim.

VIII. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria ose Sektori përgjegjës për zbatimin e aktivitetit tek **Komisioni për Barazinë Gjinore (KBGJ) i cili do të ngrihet menjëherë pas miratimit të këtij PVVBGJ në nivel të Bashkisë, me drejtuese dhe drejtues nga secila Drejtori përgjegjëse për zbatimin e PVVBGJ, në Bashki.** Menjëherë pas miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2028, si hap i parë i zbatimit të tij, do të hartohen gjithashtu edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike. **Raportimet mbi aktivitetet** do të jenë **periodike (çdo 3 muaj)** ose në bazë të kërkesës së Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel bashkie, apo Kabinetit të

Kryetares. **Raportimet në bazë të objektivave specifike** do të përgatiten *dy herë në vit (çdo 6 muaj)*.

Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit **në nivel të objektivave** do të kryhet nga **Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale në nivel të Këshillit Bashkiak**.

Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Aleanca e Grave Këshilltare dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), por edhe në Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore.

Bazuar në monitorimin e kryer, PVVBGJ duhet të **rishikohet dhe përmirësohet** në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VËZHGIMI PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE

- Raportime 6- mujore dhe një vjeçare nga mekanizimi i kordinimit.
- Vlerësime të performances ndërinstucionale.
- Feedback nga komuniteti, veçanërisht nga grate dhe vajzat përfituese.
- Sistemi i ndjekjes së rasteve dhe përditësimi i indikatorëve gjinorë.
- Anketime me qytetarët dhe përfitime.
- Rishikime të planit çdo vit në bashkëpunim me këshillin bashkiak dhe OSHC-të.

